MONUMENTET

Kronikani turk Evlija Çelebi që ka ardhur në qytetin e Beratit në 1670, përshkruan së pranë portës s së kalasë me orientim nga perëndimi ndodhet një manastir i hershëm, i groposur përpara kompleksit të tri objekteve të kultit të krishterë....

Një manastir fshihet pranë kalasë së Beratit





Lart: **Dritan Çoku restaurator**
Në foto: **Kalaja e Beratit**

Dino Kaja

BERAT

Dritan Çoku: Asnjë gërmim arkeologjik që prej vitit 1978

Rajoni i Beratit me qytetin kështjellë që i përket shek.IV,p.e.s sonë, i vlerë suar si "minierë" e kulturës, historisë dhe arkitekturës veç vlerave mbitokësore mbart edhe shumë pasuri të tjera historike e kulturore të cilat ndodhen nëntokë dhe që presin të hidhet dritë nëpërmjet gërmimeve arkeologjike. Por, që prej vitit 1978 në qytetin e Beratit nuk ka pasur asnjë gërmim arkeologjik të mirëfilltë, profesional e shkencor që të do të nxirrte në dritë mjaft vlera të rralla historike, arkitektonike e kulturore të këtij qyteti, të cilat ndodhen ende të groposura nëntokë. Këtë fakt e pohon edhe specialisti, restaurator i arkitekturës popullore pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat, Dritan Çoku i cili në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", konfirmon se në qendrën historike ndodhen të groposura nëntokë mjaft vlera të kulturës dhe historisë sonë kombëtare. Çoku pohon se duke pasur parasysh vazhdimësinë e jetesës në qytetin e fortifikuar, në kalanë e Beratit pjesa më e madhe e kishave janë ngritur mbi rrënojat e kishave më të hershme,(pra kanë respektuar konturet e mureve më të hershëm). Të vetmet gërmime arkeologjikë të pjesshme janë bërë në kalanë e qytetit vitet 1972, 1974 dhe 1978, nga arkeologia dhe historiania Hëna Spahiu, nga ku janë zbuluar monedha, qeramikë, dhe elemente të tjerë si rrënoja, të cilat janë publikuar edhe në buletinin arkeologjik, e në mjaft artikuj shkencor të revistës periodike të monumenteve të kulturës. Por, gërmimet arkeologjike fatkeqësisht mungojnë prej më se 32 vjetësh. Sipas specialistit Çoku, arkeologu Prof. Dr. Neritan Ceka në një artikull shkencor në revistën periodike "Monumentet" me titull 'Emri i lashtë i Beratit antik' ku shkruan hipotezën e tij në dy versione: Partha - Bardhë - Berat, dhe e dyta rrënja e fjalës të qytetit ilir Barguli në Barg-Bardhë dhe më pas u sllavizua në Beligrad. "Por e gjitha kjo është hipotezë ndaj mendoj se gërmimet arkeologjike në kalanë e Beratit do të hedhin dritë për përcaktimin e emrit të qytetit të lashtë e antik të Beratit" - është shprehur Çoku. Ai pohon gjithashtu se zbulimet arkeologjike në qytetin e Beratit do të nxirrnin në pah mjaft vepra të kultit që ndodhen nën tokë në kalanë e Beratit, jo vetëm.

OBJEKTI

Specialisti beratas shkon më tej kur thotë se "një nga objektet që do të mund të zbulohet nga gërmimet arkeologjike, është një manastir i hershëm ku sipas kronikanit gjeograf Evlija Çelebi, i cili ka ardhur në qytetin e Beratit në 1670, përshkruan se pranë portës me orientim nga perëndimi ndodhet një manastir i hershëm, i groposur përpara kompleksit të tri objekteve të kultit të krishterë, përkatësisht kishës së Shën Mëri Vllahernës (shek XIII-XIV), kishës së Shën Kollit (1591) dhe kishës së Shën Kostandinit dhe Helenës (1635)". Çoku thotë se gërmimet arkeologjike do të nxirrnin në pah në kalanë e qytetit rrënojat e periudhës së paleokrishtërimit që i përkasin shekullit IV-VI të erës sonë, sidomos në kohën e Justinianit të I-rë, 527-565 i e.s ku ndihej një përkujdesje perandorake. Duke pasur parasysh mjaft elementë paleokristian të ripërdorur si p.sh në kishën e Shën Todrit, kolona e kthyer përmbys, kolona me një kryq në gjithë gjatësinë e saj, 3 tjegullat solemne me gjatësi 54cm në formë govate që gjenden në apsidën po të kësaj kishe, e cila është ndërtuar mbi rrënojat e një kishe më të hershme. "Brenda në faltore në anën lindore tek apsida shohim të lexueshme apsidën e një faze më të hershme, ndërsa ajo që kemi sot është faza e ndërtimit që datonë në shek. XVI dhe pikturuar nga Onufri në 1555. Po brenda kësaj faltoreje, ndodhet një pllakë e thyer me një kryq e cila shërbente si pezull dritareje, edhe ky në tjetër element paleokristian. Dy elemente të tjerë mjaft interesant që janë ripërdorur në kishën e Shën Triadhës bëhet fjalë për dy kapitelet; njeri i stilit jonik dhe tjetri korintik janë të periudhës së antikitetit", - ka rikonfirmuar restauruesi D.Çoku i cili tregon se mbi muraturën e gurit të rrënojave të këtyre kishave të hershme janë ndërtuar dhe Kishat e Shën Mëri Vllahernës, Shën Kollit etj, ku janë gjetur elemente të tjerë paleokristianë.

GREQIA GËRMON PËR THESARIN E ALI PASHË TEPELENËS

Një grup kërkuesish të thareve janë vënë në kërkim të thesarit përrallor që i përkiste Ali Pashë Tepelenës, pashait shqiptar, guvernatorit të territoreve europiane të Perandorisë Otomane në periudhën 1744- 1822. Nuk janë pak, por 30 tonë ar dhe bizhuteri. Një grup kërkuesish thesaresh kanë nisur kërkimet e tyre në fshatin e vogël Vasiliki, 350 km në veri të Athinës. Kërkimet janë mbështetur dhe nga autoritetet vendase. Në krye të grupit kërkues është një qytetar Greko-Amerikan, identiteti i të cilit nuk bëhet i ditur. Lajmi mësohet nga agjencia e lajmeve italiane Ansa. Sipas kryetari të Bashkisë Vaios Ziakas, kryetari i këtij grupi ka në dore një dokument historik për vendndodhjen e thesarit të rrallë. Operacioni në të cilin do të përdoren edhe dy ekskavatorë si dhe mjete të sofistikuara për zbulim thesaresh do të nisë në një zonë të Vasiliqisë, fshat i cili mban edhe emrin e gruas së preferuar të Ali Pashë Tepelenës. Ali Pashë Tepelena sundimtar i fuqishëm feudal në Shqipërinë Jugore, themelues i pashallëkut faktikisht autonom të Janinës, kryengritës kundër pushtetit të Portës Osmane në Shqipëri.

MOIKOM ZEQO, EKSPOZITË NË "ZENIT"

Në galerinë "Zenit" është hapur ekspozita e arkeologut, historianit, studiuesit, Moikom Zeqo. "Kuajt e Suiftit" është grishja e radhës për artistin që sjell 63 piktura në ambientet e kësaj galerie, e cila do të qëndrojë e hapur për publikun deri më datën 21 shtator. Pikturat na përballin me ciklet e kuajve, të nudove, ciklet mitologjike dhe portretet e shkrimtarëve. Zeqo e ka quajtur kështu ekspozitën jo vetëm se numri më i madh i pikturave i takojnë këtij cikli, por edhe pse koncepti që i ka krijuar bazohet në motivin e kuajve, grishje e autorit Xhonatan Suift nga libri "Udhëtimet e Guliverit". Është një vepër që ai e vlerëson një nga "më emblematiket e njerëzimit, e shkruar nga një shkrimtar gjenial dhe i papërsëritshëm". I njohur si poet dhe prozator, subjektet e tij janë tregime të shpirtit, përrallore, ekzistenciale dhe mistike. Sigurisht, proza e tij është një prozë që nuk ngjan me prozat e kolegëve prozatorë, është një prozë e ngjashme me vetveten. Kështu prezantohet edhe në pikturë, ku Zeqo i rrotullon botët dhe ngjarjet në një vërtitje impresionuese, duke na treguar se ai e njeh sekretin e universalitetit të subjekteve.

OSCE

ORGANIZATION FOR SECURITY AND CO-OPERATION IN EUROPE
OSCE PRESENCE IN ALBANIA
Sheraton Tirana Hotel and Towers, 1st Floor
Sheshi "Italia", Tirana

The OSCE Presence in Albania is seeking a

NATIONAL PROJECT CO-ORDINATOR (NP2)

for the Immovable Property Registration and Road Signage in Priority Coastal Areas project. The project is being implemented through the Presence's Governance in Economic and Environmental Issues Department. The appointment is envisaged for 12 months, limited extension is possible subject to availability of Project funds.

BACKGROUND
In 1993 the Government of Albania authorized the creation of the Immovable Property Registration System (IPRS) to serve as a modern, European style land and property rights registry. Since that time, international donor organizations have provided financing and technical assistance to the IPRS. Beginning in 2005, the OSCE Presence in Albania has implemented technical assistance projects in collaboration with the IPRS to carry out the systematic first registration of immovable property. The Presence is currently implementing a European Union funded project that aims to carry out systematic first registration of immovable property in Albania's southern coastal area.

DUTIES AND RESPONSIBILITIES
The incumbent works under the supervision of the Presence International Property Law Specialist/Team Leader and performs the following tasks in support of the Project for systematic first registration of immovable properties:
1. Represents the Project to stakeholders including the IPRS, local government officials, civil society groups and property ownersandfacilitatesclosecollaborationwithstakeholderstoensureintegratedimplementationoftheProject;
2. Co-ordinates implementation of a public outreach programme to ensure public participation and transparency in the registration process;
3. Co-ordinates and monitors property registration activities in the field to ensure efficiency and the quality of the registration information produced under the Project;
4. Assists in the preparation of progress reports and provides recommendations to make the registration process more efficient;
5. Assists the Presence to analyse the legal framework governing the registration process and propose amendments where appropriate;
6. Although based in Tirana, frequent travel outside Tirana will be required;
7. Performs other duties as required.

QUALIFICATIONS AND SKILLS:
- University degree in law, geodetic engineering, anthropology or other relevant fields;
- Four years professional work experience on donor-financed systematic first registration, rule of law or public participation projects in Albania;
- Expert knowledge of land/property sector issues in Albania;
- Demonstrated project management experience, preferably in the land/property sector;
- Proven skills to build links between international organizations and national institutions;
- Excellent communication skills in English and local languages;
- Ability to work with people of different nationalities, religions and cultural backgrounds;
- Self- starter with the ability to work independently;
- Must be Albanian national or permanent resident;
- Valid driver's license.

REMUNERATION PACKAGE
According to the fixed OSCE salary scale, the monthly remuneration is approximately 1,488.58 EUR, subject to national social security deductions.

APPLICATION PROCEDURE FOR THIS POSITION VNALBN00198:
To apply for this position, please use the OSCE's online application link http://www.osce.org/employment, or complete the application form offline (RTF), to be found under http://www.osce.org/employment/13108.html and submit it through one of the following ways:
1. By e-mail: recruitment-al@osce.org
2. By sending a hard copy to the following address:
Human Resources Office
Sheraton Tirana Hotel & Towers, 1st Floor, Sheshi "Italia", Tirana, Albania
Telephone: +355 4 240001/4/5 – 305

Please note that online applications are strongly recommended. Please indicate the VN number when applying. Applications that are not submitted through the OSCE Application Form will not be considered.

All applications are due by: 04 October 2010. Duly qualified applicants will be contacted and informed when the qualifying written tests and interviews will take place.

The OSCE, as an equal opportunity organization, encourages female candidates to apply.